



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 499/Prot  
3

Tiranë, më 16/4/2019

VENDIM

Nr. 06, datë 16.4.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 499 Prot., datë 28.03.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Prrenjjas” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 18.02.2019, ka kërkuar ti vihet në dispozicion dokumentacioni për projektet e financuara nga Fondi i Rajoneve, si më poshtë:

1. Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Sutaj dhe lagjes Qendër të fshatit Rrajcë;
2. Ndërtim shkolla CU Urakë, Komuna Rrajcë;
3. Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Pishkash, Komuna Qukës;
4. Rikonstruksion dhe rrethim shkolla e mesme “Halit Bërzeshta” Prrenjjas, Bashkia Prrenjjas;
5. Ujësjellësi i fshatit Rashtan;
6. Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale (ndriçim, gjelbërim,etj);
7. Rikonceptim i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave të qytetit Përrenjas;
8. Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Qybra Sokoli";
9. Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i kurorës së qytetit Prrenjjas.

Shoqëruar me dokumentet:

- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë projektuese.*
- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë zbatuese.*
- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë supervizuese.*
- *Kompani nënkontraktuese për zbatimin e projektit.*
- *Cili është statusi aktual i projektit, tenderuar, në ndërtim, përfunduar.*

Me pretendimin se është çënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur fillimisht ankimin nr. 499 Prot., datë 28.03.2019 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 499/1 Prot, datë 29.03.2019, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni. Në vijim, me shkresën nr. 515/1 Prot., datë 04.04.2019, administruar me tonën nr. 499/2 Prot., datë 09.04.2019, Autoriteti Publik ka kthyer pjesërisht përgjigje duke vënë në dispozicion një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

Duke qenë se detyrimi nuk është përmbushur plotësisht, ankuesi ka vijuar me ankimin datë 05.04.2019, me pretendimin se: *“Autoriteti Publik ka dërguar vetëm kontratat me kompanitë zbatuese të projekteve dhe asnjë kontratë me kompanitë projektuese dhe mbikqyrëse. Gjithashtu, lidhur me projektin “Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Sutaj dhe lagjes Qendër të fshatit Rajcë”, nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion/ dokumentacion”.*

Me anë të emailit datë 08.04.2019, Autoriteti Publik pretendon se: *“Këto kontrata, objekt i kërkesës për informacion, janë kryer në kohën kur kishte komuna dhe jo bashki, për rrjedhim nuk i disponojmë”.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Bazuar në pikën 1 të Kreut V “Transferimi i arkivave dhe dokumentacionit”, të VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, parashikohet se: *“Bashkia është trashëgimtarja e ligjshme e NJSH-ve (ish komunave) dhe është përgjegjësia e ardhshme për arkivat e këtyre njësive, për të vendosur për administrimin e mëtejshëm të dokumenteve...”.*

Ndërkohë, nga ana e Autoritetit Publik, nuk është bërë verifikimi i dokumentacionit të pretenduar nga ankuesi, por është mjaftuar vetëm me faktin se këto procedura janë kryer në kohën kur kishte komuna dhe jo bashki. Pretendim ky, që bie në kundërshtim me pjesën tjetër të vënë në dispozicion të kërkuarit, që ka të bëjë pikërisht me njësitë administrative (ish komunat).



Komisioneri, me urdhrin nr. 141, datë 20.05.2016 "Për miratimin e udhëzuesit "Autoritetet Publike në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit", vlerëson se, Autoritet Publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" konsiderohet organi/zyra qendror (e). Rrjedhimisht, Bashkia Prrenjas, është Autoriteti Publik përgjegjës për të gjitha njësitë administrative në varësi të saj.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi, këtë të fundit për koordinimin midis njësive administrative dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Theksojmë gjithashtu se, ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ka për qëllim të nxisë përfundimisht e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", konkretisht, Neni 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", në të cilin parashikon se: "1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre."

Si përfundim, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Birn Albania" ndaj Bashkisë Prrenjas, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 499 Prot., datë 28.03.2019 të Qendrës "Birn Albania", përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik "Bashkia Prrenjas", me

- objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar për projektet e financuara nga Fondi i Rajoneve, si më poshtë:
- 2.1. Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Sutaj dhe lagjes Qendër të fshatit Rrajcë, konkretisht:
- Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë projektuese.
  - Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë zbatuese.
  - Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë supervizuese.
  - Kompani nënkontraktuese për zbatimin e projektit.
  - Cili është statusi aktual i projektit, tenderuar, në ndërtim, përfunduar.
- 2.2. Ndërtim shkolla CU Urakë, Komuna Rrajcë;
- 2.3. Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare "Naim Frashëri", Pishkash, Komuna Qukës;
- 2.4. Rikonstruksion dhe rrethim shkolla e mesme "Halit Bërzeshta" Prrenjas, Bashkia Prrenjas;
- 2.5. Ujësjellësi i fshatit Rashtan;
- 2.6. Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale (ndriçim, gjelbërim, etj);
- 2.7. Rikonceptim i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave të qytetit Prrenjas;
- 2.8. Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Qybra Sokoli";
- 2.9. Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i kurorës së qytetit Prrenjas, konkretisht:
- Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë projektuese.
  - Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë supervizuese, brenda datës 24.4.2019.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.4.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

